

**UNIVERSITETI I PRISHTINËS  
FAKULTETI I FILOLOGJISË**

**dhe**

**UNIVERSITETI I TIRANËS  
FAKULTETI I HISTORISË DHE I FILOLOGJISË**

---

**SEMINARI NDËRKOMBËTAR PËR GJUHËN, LETËRSINË DHE  
KULTURËN SHQIPTARE**

---

**Materialet e punimeve të Seminarit XXXI Ndërkombëtar për Gjuhën,  
Letërsinë dhe Kulturën Shqiptare  
Prishtinë, 13-25 gusht 2012**



**Gjorgje BOZHVIQ**

**THEKSI I FJALËS NË MORFONOLOGJI TË SHQIPES:  
TEORIA METRIKE DHE E OPTIMALITETIT**

Theksi i fjalës në shqipen rregullisht vendoset mbi morën e parë të këmbës metrike dymorëshe të fundit të rrënjës së fjalës, ashtu që të gjithë tema gramatikore janë paroksite apo trokaikë. Mbaresat flektive janë metrikisht të parëndësishme për rregullat e vendosjes së theksit në morfonologjinë e shqipes, ashtu që theksi i fjalës në shqipen mbetet i palëvizshëm në morfologji të fjalëve. Përbrenda teorisë së optimalitetit, shtrëngesat fonologjike të theksimit dhe të këmbëve metrike të fjalëve në gjuhën shqipe do të thonë, mes të tjerave, që këmbët në fonologji të shqipes janë binare dhe trokaikë, dhe në fjalët strukturohen nga djathtas–majtas; që çdo rrokje në fjalë duhet t’i përket këmbës së saj; edhe që theksimi i shqipes në përgjithësi varet nga sasia fonologjike.

**1. Hyrje**

**§I.** Përshkrimi gjuhësor i strukturës prozodike të gjuhës shqipe mbetet midis çështjeve ende të pazgjidhura në kërkimet e sotme të morfonologjisë së shqipes. Ashtu p. sh. vendosja e theksit të fjalës në gjuhën shqipe në literaturën albanologjike zakonisht merret si një fenomen fonetik, i parregullt dhe i paparashikueshëm. Kryesisht në gramatikat deskriptive–tradicionale të gjuhës shqipe qëndron mendimi se vendosja e theksit të fjalës në prozodinë e shqipes nuk mund të përcaktohet me rregullat gramatikore (kq. p. sh. Dodi & Gjinari 1983: 129).

Theksi i fjalës, apo theksi leksikor, përkufizohet në fonetikë dhe në fonologji si efekti i prodhuar nga shqiptimi më i fuqishëm i njëjës prej rrokjeve të fjalës — asaj të theksuar; se shqiptimi i të tjerave — të patheksuara. Ky lloj i theksit, andaj, bëhet jo vetëm thjesht fonetik, por edhe njësi morfonologjike e gjuhës, se funksionon si shenja e qëndrueshme e fjalëve në të folurit. Kështu theksi leksikor ndryshon nga ai i fjalisë, apo theksi sintaksor, i cili varet nga konteksti paralinguistik ose pragmatik, dhe prandaj nuk bëhet njësi strukturore e gjuhës vetë. Ky dallim midis të dy llojeve të theksit — njëri në përgjithësi thjesht fonetik e paralinguistik, dhe i tjetri krejt strukturor morfonologjik — mbetet ende i pavëzhguar në studimet gjuhësore deskriptive–tradicionale të shqipes, ashtu siç të gjuhëve të tjera.

## 2. Themelimi i aksentologjisë së shqipes

§II. Nga ana tjetër, për shkak që gramatika transformativë–gjenerative e ka një aparat eksplanator më të fortë se ai i gramatikës deskriptive–tradicionale, në literaturë shfaqen edhe ca shpjegime teorike të vendosjes së theksit leksikor në gjuhën shqipe përbrenda kësaj teorie të gjuhës. I pari që ka provuar t’i formulojë rregullat e vendosjes së theksit të fjalës në gjuhën shqipe sipas fonologjisë gjenerative standarde, të themeluar në veprën e Chomsky-t & Halle-s (1968), ishte Bevington-i (1974: 24–25); kq. rregull të tij në (1):

$$(1) \quad V \rightarrow [+ \text{theksuar}] / \_ C_0 ]_{\text{temë}} \begin{pmatrix} e \\ a \\ o \\ \text{ə}(C) \\ as \\ ut \end{pmatrix} \quad [- \text{folje}]$$

Megjithatë, kjo rregull, siç e ka formuluar Bevington-i, nuk i referohet klasës natyrale fonologjike, dhe e ndryshon vendosjen e theksit në temat emërore prej asaj në temat foljore të shqipes. Gjithashtu, nuk i përfshin ato tema emërore që mbarojnë me zanoret [e], [a] dhe [o] të theksuara (si p. sh. *kafé, pará, byró*, etj.), ato q’ e kanë zanoren [ə] në rrokjen e theksuar (si p. sh. *jasték*), apo ato tema njërrrokëshe me mbaresat në (1), të cilat sipas Bevington-it nuk do të merrnin asnjë theks (p. sh. *fe, ka* etj.). Bevington-i me rregull të tij gjithashtu nuk i përfshin as ato tema emërore me mbaresën –[ur] të patheksuar (siç *flútur*), dhe duhet t’i trajtojë temat që mbarojnë me diftong me një rregull fare tjetër (Canalis 2007: 5; Bevington 1974: 26).

§III. Mirëpo, qëndrimi i shpallur te Bevington-i — që rregullat e vendosjes së theksit të fjalës në shqipen zbatohen vetëm brenda domenit të temës, apo rrënjës së fjalës, në mënyrë që mbaresat flektive janë metrikisht të parëndësishme, por sufiksët të derivacionit të fjalëve janë nënshtruar rregullave ciklike të vendosjes së theksit të fjalës, dmth. që vendosja e theksit në gjuhën shqipe është e ndjeshme ndaj kontekstit morfologjik të fjalës, siç më vonë pikërisht do të jetë hulumtuar brenda teorisë së fonologjisë leksikore (p. sh. Kiparsky 1982; Mohanan 1986); — faktikisht e ka mundësuar përgjithësimin teorik të rregullave të vendosjes së theksit në morfologjinë e shqipes. Qëndrim të njëjtë ndaj temës gramatikore të fjalës si domenit të vërtetë të vendosjes së theksit do ta marrin edhe kërkuesit e tjerë të sistemit aksentor të gjuhës shqipe. Edhe pse në të vërtetë më shumë intuitivisht, sesa krejt formalisht, kjo ishte e vërejtur edhe te Newmark-u et al. (1982: 15) dhe Buchholz-i & Fiedler-i (1987: 53).

### 3. Teoria e optimalitetit

§IV. Pas Bevington-it, disa hulumtime të tjera gjuhësore të aksentologjisë së shqipes kanë vazhduar të bëheshin sipas teorisë transformative–gjenerative të fonologjisë, kryesisht në fushën e teorisë së optimalitetit (Maynard 1997; Trommer 2004; 2009), si edhe në fushën e teorisë metrike të fonologjisë (Canalis 2007). Të gjithë pajtohen patjetër që domeni i vërtetë i rregullave të vendosjes së theksit leksikor në shqipen është vetëm tema gramatikore e fjalës, dmth. që ato morfema flektive djathtas kufirit të temës janë të parëndësishme për vendosjen e theksit, prandaj rregullat e saj nuk zbatohen mbi to. Të dhënat e gjuhës shqipe e konfirmojnë këtë qëndrim, se mbaresat flektive në shqipen kurrë nuk janë të theksuara. (Përveç mbaresave të numrin shumë të emrave, të tipit  $[-iɲ]$ ,  $[-eɲ]$ , p. sh. *lúm : lum-énj*, por ato mbaresa janë të rimorfologjizuar sipas analogjisë me mbaresën e shumës  $[-ɲ] < *-n-ai$ , siç në *ftua : ftonj*, që të sillen në gjuhë si mbaresat e përbërë nga zgjerimi i temës gramatikore të fjalës, i tipit  $[-in]$ ,  $[-en]$ , me mbaresën e numrin shumë të emrave  $[-j] < *-ai$ , kështu që faktikisht temat e plotë të rimorfologjizuar t'atyre emrave janë në sinkroni të gjuhës të theksuara sipas analogjisë, dhe jo mbaresat; kq. edhe tek Orel-i 2000: 230–231).

§V. Pra, një kërkim tjetër fonologjik i sistemit theksor të gjuhës shqipe ka qenë i kryer nga Maynard-i (1997) sipas teorisë së optimalitetit të fonologjisë së gjuhës, një teorie të re në gjuhësinë gjenerative, të themeluar në veprën e Prince-it & Smolensky-t (1993). Analiza e saj e theksit leksikor të shqipes i ka zbuluar ca shtrëngesa të rëndësishme të fonologjisë së gjuhës shqipe (p. sh. orientimin e djathtë të theksit në shqipen), ashtu si rangun e tyre në strukturën morfonologjike të shqipes, por prapëseprapë asaj i mungon një formulim krejt i pranueshëm i rregullave të vendosjes së theksit të fjalës në shqipen; kq. në (2).

#### (2) FUTJE FONOLOGJIKE: *pú.në.-tór*

	Një theks për fjalë	Besnikëria e nxjerrjes	Theksoje anën e djathtë
<i>pú.në.-tór</i>	*!		
<i>pú.në.-tor</i>		*	*!
➤ <i>pu.në.-tór</i>		*	
<i>pu.në.-tor</i>		**!	

§VI. Një analizë tjetër, e kryer nga Trommer-i (2004; 2009), gjithasthu përfundon që theksi i fjalës në shqipen e ka orientimin e djathtë, por që është i


ndjeshëm ndaj cilësisë, apo kualitetit të zanoreve, ashtu si edhe ndaj peshës së rrokjeve të fjalës. Trommer-i (2009) e bëri një kërkim edhe më tutje në palëvizjen morfologjike të theksit leksikor të shqipes, duke vënë në dukje një analizë ciklike të palëvizjes së theksit të shqipes (kq. Bermúdez-Otero 2011); kq. formulimin e tij të shtrëngesave të vendosjes së theksit të fjalës, dhe rangun e tyre në shqipen në (3), si e paraqitur te Canalis-i (2007); dhe analizën e tij të palëvizjes së vendosjes stratale-ciklike të theksit të fjalës në (4), siç e paraqiti Bermúdez-Otero (2011).

- (3)  $*[\text{ə}]_{\sigma}[\text{temë}] \gg \text{peshë/theks}[\text{temë}] \gg *[-\text{mbyllur} -\text{hapur}]_{\sigma}[\text{temë}] \gg$   
 VENDOSE( , djathtë, temë, djathtë)  $\gg *[\text{+mbyllur}]_{\sigma}[\text{temë}] \gg *[\text{+hapur}]_{\sigma}[\text{temë}]$

Shtërngesa fonologjike VENDOSE( , djathtë, temë, djathtë) e thekson anën e djathtë të temës së fjalës, por shtërngesa  $*[-\text{mbyllur} -\text{hapur}]_{\sigma}[\text{temë}]$  parandalon që të theksohen zanoret gjysmë të mbyllura kur janë në fundin e djathtë të temës. Mirëpo, zanoret gjysmë të mbyllura janë të theksuara kur ndodhen në një rrokje të mbyllur, dhe shtërngesa për vendosjen e theksit mbi rrokjen e mbyllur, sipas peshës së rrokjes (peshë/theks) $[\text{temë}]$ , e mundëson atë se rreshtohet më lart sesa shtërngesa  $*[-\text{mbyllur} -\text{hapur}]_{\sigma}[\text{temë}]$ . Zanorja [ə] është më rrallë e theksuar, dhe rangi i shtërngesës fonologjike  $*[\text{ə}]_{\sigma}[\text{temë}]$  e pasqyron atë fenomen. Më në fund, shtërngesat fonologjike  $*[\text{+mbyllur}]_{\sigma}[\text{temë}]$  dhe  $*[\text{+hapur}]_{\sigma}[\text{temë}]$  e pasqyrojnë dukurinë që zanoret [i] e [a] janë më shpesh të theksuara në shqipen, kur ndodhen në rrokjen e fundit të temës së fjalës.

Megjithatë, sipas Canalis-it (2007: 6–8), ka edhe disa probleme me atë analizë teorike të theksit të fjalës në shqipen, të Trommer-it, siç në (3). Një shpjegim plotësisht i pranueshëm i ekzistencës së rrokjeve të theksuara me zanoren [ə] në gjuhën shqipe te Trommer-i mungon. S'ka shpjegim për temat që mbarojnë me  $-\text{[u]}$  të patheksuar, dhe shpjegimi i Trommer-it për temat që mbarojnë me  $-\text{[ur]}$  të patheksuar nuk i përfshin të gjithë raste të kësaj dukurie. Po në fund të fundit, qëndrimi teorik më origjinal i analizës së tij — ai, që cilësia e zanoreve ndikon vendosjen e theksit të fjalës në shqipen — sipas tipologjisë së gjuhëve duket pak i çuditshëm, sepse Trommer-i e lidh theksimin e zanoreve jo me sonoritetin e tyre, por me periferalitetin e tyre në sistemin zanoresh, kështu që zanoret joqendrore gjysmë të mbyllura, [e] dhe [o], tek ai duken të jenë tipologjisht më të preferueshme kur janë të patheksuara sesa, siç pritet, kur janë të theksuara (Canalis 2007: 6–7); në fjalët e Canalis-it:

There are some problems with this proposal. Some involve further constraints, which [...] look more descriptive than explicative. [...] With regard to one of [Trommer's] central claims, that regarding the influence of the vowel quality on stress position, from a typological point of view stress systems influenced by vowel quality are attested [...]. But they are all based on the sonority scale: more sonorous vowels tend to attract stress, and less sonorous vowels tend to avoid it. Instead according to Trommer in Albanian there would be a hierarchy of stressability /i a u y/ > /e o/ > /ə/ (going from the most easily stressable vowels to the least stressable), since central vowels would avoid stress more than peripheral vowels. Now, in numberless languages [ə] is typical of unstressed vowels, but this proposal is much less well-grounded for mid non-central vowels. As a matter of fact, in several languages mid vowels are possible only if stressed [...]. Moving from more theoretical problems to the empirical, [...] the validity of [Trommer's] constraints is only statistical [...].




#### 4. Teoria metrike e fonologjisë

§VII. Canalis-i (2007) e ka kryer një analizë teorike të theksit të fjalës të shqipes sipas teorisë metrike të fonologjisë (kq. Liberman & Prince 1977; Hayes 1995). Analiza metrike e tij e vendosjes së theksit leksikor në shqipen është bazuar në propozimin që theksimi i gjuhës shqipe varet nga pesha e rrokjeve, ashtu si te Trommer-i (2004; 2009), që zbatohet vetëm në domenin e temës së fjalës, ashtu si te Bevington-i (1974) e të tjerët, dhe q'ë ka një orientim të djathtë, ashtu si te Maynard-i (1997). Sipas Canalis-it, shqipja është në morfonologjinë e saj e ndjeshme ndaj sasisë metrike, apo kuantitetit të rrokjeve, dmth. ndaj numrit të morave të tyre, apo peshës së tyre, dhe jo ndaj cilësisë së zanoreve në rrokje. Rrokjet mund të jenë të rënda, kur janë të gjata ose të mbyllura, apo kur e përmbajnë ndonjë diftong, e prandaj përbëhen nga dy mora; apo mund të jenë të lehta, kur janë të shkurta dhe të hapura, e prandaj përbëhen nga një morë metrike. Rrokjet dhe morat e tyre i formojnë këmbët metrike. Prandaj, në prozodinë e shqipes, në fjalët e Canalis-it, këmba kryesore dhe e theksuar gjendet në fundin e djathtë të temës së fjalës, dhe është e përbërë nga dy mora me aksentin paroksiton.

Në fjalë të tjera, rregulla e vendosjes së theksit të fjalës në shqipen do të thoshte se, në çdo fjalë të gjuhës shqipe, theksi kryesor vendoset mbi morën e parë të këmbës më të djathtë dymorëshe të temës së fjalës, dmth. që të gjithë temat e shqipes janë paroksitone, me theksin në morën e parafundit (dmth.  $\overset{\sim}{\sim}$  ]temë,  $\overset{\sim}{\sim}$  ]temë,  $\overset{\sim}{\sim}$  ]temë). Kështu, në qoftë se tema mbaron me dy rrokje të lehta, të shkurta dhe të hapura, si *púnë, lúle, bórë, yndýrë, prápa, brénda, anembánë* etj., të dy e përbëjnë një këmbë trokaike dymorëshe, me theksin paroksiton. Në qoftë se tema mbaron me një rrokje të rëndë, qoftë e gjatë ose e mbyllur, qoftë me diftong, ajo rrokje vetë e përbën një këmbë dymorëshe, e prandaj është e theksuar, si *vénd, bilbíl, shtëpí, barí, kalá* etj. (për ato emra me theksin e fundit të temës, të cilat në toskërishten e kanë një morë të përfjetur që aktivizohet nëpër rasa, si *shtë.pí ( ) : shtë.pí .së*, derisa gegërishtja e ka një rrokje të gjatë dymorëshe, si *shpí : shpís*, kq. te Canalis-i 2007: 11–13), edhe si *pú:n, bó:r, anembá:n* etj. në gegërishten; kq. në (5) dhe (6). Kjo do të thotë se vendosja e theksit në shqipen zbatohet jo thjesht në nivelin e rrokjeve të fjalëve, por edhe më ulët dhe hollësisht, në nivelin e morave dhe të këmbëve metrike *t'* atyre rrokjeve.



(5) Vendosja e theksit në shqipen mbi rrokjet e lehta:




Mbaresat e patheksuara –[ur] dhe –[uɽ] Canalis-i (2007: 10–11) i shpjegon në mënyrë fonotaktike, si pasojën e sipërfaqësor të rregullave të organizimit të rrokjes së shqipes, dmth. të shtrëngesave fonotaktike të rrokjes, q’ e parandalojnë shfaqjen e bashkëtingëlloreve [ɾ] dhe [ɽ] në fundin e rrokjes së mbyllur. Prandaj zanorja [u] në raste të tillë funksionon si zanorja e sipërfaqësor fonologjike që s’ka vlerë të asnjë more për vendosjen e theksit të fjalës, e prandaj mbetet pa theks; kq. në (5).

(6) Vendosja e theksit në shqipen mbi rrokjet e rënda:


a) mbi rrokjet e mbyllura

b) mbi rrokjet me diftongun



c) mbi rrokjet me morën e përfjetur (tosk.)

d) mbi rrokjet e gjata (geg.)



## 5. Përfundim

§VIII. Që ta shpjegojmë këtë analizë metrike të theksimit paroksiton të shqipes sipas teorisë së optimalitetit (Prince & Smolensky 1993), duhet t'i formulojmë shtrëngesat e sakta fonologjike të sistemit aksentor të shqipes. Siç u tha, shtrëngesat e optimalitetit fonologjik të formuluar nga Trommer-i (2004; 2009) janë më shumë thjesht statistike, sesa janë krejtësisht strukturale dhe formale. Përkundrazi, shtrëngesat formale fonologjike të vendosjes së theksit të fjalës në shqipen duhet t'i përcaktojnë sistemin e theksimit shqip në tërësinë e tij, jo vetëm tendencat e tij që shfaqen në sipërfaqe. Sipas analizës metrike të theksimit shqip të Canalis-it (2007), mund t'i përcaktojmë këto shtrëngesa të optimalitetit fonologjik që funksionojnë në sistemin morfonologjik dhe prozodik të gjuhës shqipe (kq. Prince & Smolensky 1993; Tesar & Smolensky 2000): FOOTBIN, apo KËMBA ËSHTË BINARE (dmth. këmba metrike duhet të jetë dymorëshe ose dyrokëshe); TROCHAIC, dmth. KËMBA ËSHTË TROKAIKE (këmba metrike e shqipes është paroksitone); ALL-FEET-RIGHT dhe MAIN-RIGHT, dmth. KËMBËT E FJALËS STRUKTUROHEN NGA DJATHHTAS–MAJTAS (orientimi i strukturës prozodike të shqipes është i djathtë, dmth. nga kufiri i djathtë i rrënjëve të fjalëve); PARSE– , apo ÇDO RROKJE DUHET T'I PËRKET KËMBËS (dmth. secilës prej rrokjeve të fjalës duhet t'i jetë caktuar një këmbë); edhe WEIGHT-TO-STRESS-PRINCIPLE (peshë/theks]<sub>temë</sub>), apo THEKSIMI VARET NGA SASIA E RROKJES (dmth. rrokjet e rënda e tërheqin theksin; rreth kontekstit areal–gjuhësor të kësaj dukurie të veçantë fonologjike kq. te Stanišić-i 2003). Rangu i saktë i këtyre shtrëngesave të optimalitetit fonologjik do ta përcaktojë tërësisht vendosjen e theksit të fjalës në morfonologjinë e shqipes.

## Referencat

1. Bermúdez-Otero, R. (2011). Cyclicity. In press, in: M. van Oostendorp et al. (eds.), *The Blackwell Companion to Phonology*. Malden, MA: Wiley-Blackwell.
2. Bevington, G. L. (1974). *Albanian Phonology*. Wiesbaden: Otto Harrassowitz.
3. Buchholz, O. & Fiedler, W. (1987). *Albanische Grammatik*. Leipzig: VEB Verlag.
4. Canalis, S. (2007). To what extent is Albanian word stress predictable?. In: A. Bisetto & F. Barbieri (eds.), *Proceedings of the XXXIII Incontro di grammatica generativa* (pp. 1—14). Bologna: University of Bologna.

5. Chomsky, N. & Halle, M. (1968), *The Sound Pattern of English*. New York: Harper & Row.
6. Dodi, A. & Gjinari, J. (1983), *Fonetika dhe gramatika e gjuhës së sotme letrare shqipe, II: Fonetika*. Tiranë: AShSh.
7. Hayes, B. (1995), *Metrical Stress Theory*. Chicago: University of Chicago Press.
8. Kiparsky, P. (1982). From cyclic phonology to lexical phonology. In: H. van der Hulst & N. Smith (eds.), *The Structure of Phonological Representations*, vol. I (pp. 131—175). Dordrecht: Foris.
9. Liberman, M. & Prince, A. (1977). On stress and linguistic rhythm'. *Linguistics Inquiry*: 8 (pp. 249—336).
10. Maynard, K. L. (1997), *An optimality analysis of Albanian word stress*. In: Xingzhong Li et al. (eds.), *Papers from the 1997 Mid-America Linguistics Conference* (pp. 94—100).
11. Mohanan, K. P. (1986), *The Theory of Lexical Phonology*. Dordrecht: Kluwer.
12. Newmark, L. et al. (1982), *Standard Albanian: A Reference Grammar for Students*. Stanford: Stanford University Press.
13. Orel, V. (2000), *A Concise Historical Grammar of the Albanian Language: Reconstruction of Proto-Albanian*. Leiden: Brill.
14. Prince, A. & Smolensky, P. (1993), *Optimality Theory: Constraint Interaction in Generative Grammar*. In manuscript, Boulder: University of Colorado Boulder.
15. Stanišić, V. (2003), *Srpsko-albanski jezički dodiri i dva tipa fonoloških sistema u balkanskim jezicima*'. *Balkanica*: 34 (pp. 105—117).
16. Tesar, B. & Smolensky, P. (2000), *Learnability in Optimality Theory*. Cambridge, MA: MIT Press.
17. Trommer, J. (2004), *Albanian word stress*. In manuscript, Osnabrück: University of Osnabrück.
18. Trommer, J. (2009), *Stress uniformity in Albanian: morphological arguments for cyclicity*. In manuscript, Leipzig: University of Leipzig.

**Word Stress in the Morphology of Albanian:  
Metrical and Optimality Theories**

Word stress in Albanian regularly falls on the first mora of the stem-final bimoraic metrical foot, so that all grammatical stems are trochaic paroxytona. Inflectional endings are metrically irrelevant for the stress assignment rules in the morphology of Albanian, so that word stress in Albanian is paradigmatically fixed. Within the Optimality Theory, phonological constraints on prominence and metrical feet that can be posed to reflect this generalization in Albanian include FOOTBIN, TROCHAIC, AFR, MAIN-R, PARSE, and WSP.